



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRI I SHTETIT PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 7178/1 prot., datë 30.12.2024

Nr. 8733 prot., datë 30.12.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

MINISTRIT TË SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN/KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

DHE

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

“PËR BASHKËPUNIMIN E NDËRSJELLË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT”

Tiranë, 2024

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, (këtu e në vazhdim referuar si “Marrëveshja”) lidhet midis:

1. **Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin**, (referuar më poshtë si “MAPA”), përfaqësuar nga Znj. Adea PIRDENI, Ministër Shteti.

dhe

2. **Agjencisë së Prokurimit Publik**, (referuar më poshtë si “APP”), përfaqësuar nga Znj. Reida KASHTA, Drejtor i Përgjithshëm.

Hyrje

- *Duke vlerësuar* rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për forcimin e shtetit të së drejtës, me qëllim luftën kundër korrupsionit, shmangien e abuzimeve dhe ndëshkimin e paligjshmërive, në procedura prokurimi të zhvilluara nga ana e autoriteteve kontraktore, me synim garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe rritjes së integritetit të nëpunësve të organeve publike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjes së interesave financiarë të shtetit.
- *Duke synuar* angazhimin e përbashkët lidhur me nxitjen e subjekteve pjesëmarrëse në një procedurë prokurimi, por jo vetëm, për denoncimin/referimin e çdo rasti korrupsioni, praktike arbitrare ose abuzive, në institucionet e përcaktuara në vendimin nr. 436, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”, si dhe promovimin e praktikave më të mira në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke garantuar ligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike, në përmbushje të detyrimeve përkatëse ligjore.
- *Duke konfirmuar* angazhimin institucional të palëve nënshkruese për të marrë të gjitha masat dhe nismat e nevojshme për rritjen e informimit, ndërgjegjësimin në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, me qëllim shmangien e çdo abuzimi, diskriminimi, apo trajtimi preferencial në procedurat e prokurimit të zhvilluara për përmbushjen e nevojave/veprimtarisë së autoriteteve kontraktore, duke garantuar rritje të integritetit të nëpunësve/punonjësve të organeve publike.
- *Duke u mbështetur* në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe në parimin e përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje, duke respektuar dispozitat e saj, të shprehura si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet palëve të kësaj marrëveshjeje në kuadër të luftës kundër korrupsionit, në funksion të parandalimit të veprimeve korruptive, si dhe mirëpërdorimit të fondeve publike.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në vendimin nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në vendimin nr. 304, datë 22.05.2024, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj 2024-2027", në vendimin nr. 29, datë 17.01.2024 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin", si dhe në vendimin nr. 436, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit".

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi midis palëve lidhur me:

1. Realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për forcimin e luftës kundër korrupsionit, në prokurimin e fondeve publike;
2. Koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të hetimit administrativ për procedura prokurimi të zhvilluara nga institucionet e përcaktuara VKM nr. 436, datë 26.06.2024;
3. Nisma për kryerjen e vlerësimit të riskut të korrupsionit për procedura të kryera gjatë procesit të prokurimit publik nga autoritetet kontraktore;
4. Identifikimin dhe zbatimin e formave të qëndrueshme dhe efektive të bashkëpunimit, në përputhje me kompetencat përkatëse institucionale, me qëllim promovimin e nismave për çështje që lidhen me luftën kundër korrupsionit dhe mirëpërdorimin e fondeve publike.

Neni 4

Angazhimet e Agjencisë së Prokurimit Publik

1. APP për të gjitha rastet e referuara, për të cilat i është vendosur në dispozicion raporti përfundimtar i hetimit me gjetjet e evidentuara nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, mbi procedurën/at e prokurimit publik të zhvilluara nga institucionet e

përcaktuara në VKM nr. 436, datë 26.6.2024, shqyrton gjetjet e përcjella për të vlerësuar mbi marrjen e masave përkatëse administrative ndaj nëpunësit përgjegjës të institucionit përkatës sipas nenit 132 të ligjit nr. 162/2020, si dhe sipas rastit edhe ndaj operatorëve ekonomikë nëse konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik, dhe informon Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit mbi vendimmarrjen e saj.

2. APP, kur gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, (për institucionet e përcaktuara në VKM nr. 436, datë 26.06.2024, kur evidenton raste të veprimeve në kundërshtim me ligjin dhe që nuk janë në kompetencë të saj, bën referimin e rastit/eve pranë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, duke e bashkëshoqëruar dhe me dokumentacionin përkatës provues.
3. APP, merr përsipër sipas kërkesës së paraqitur nga ana e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, të vendosë në dispozicion nëpunës (ekspertë), të kësaj agjencie, për bashkëpunim në kryerjen e kontrolleve administrative nga ana e Koordinatorëve kundër Korrupsionit apo nga struktura përgjegjëse antikorrupsion për hetimet administrative.
4. APP, merr përsipër të vendosë në dispozicion nëpunës (ekspertë), të kësaj agjencie, për bashkëpunim në kryerjen e analizës dhe vlerësimit të riskut për korrupsion në fushën e prokurimit publik.

Neni 5

Angazhimet e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit

1. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit merr përsipër të njoftojë APP, për rastet e hetimeve të zhvilluara, kur në përfundim të hetimit konstatohet se procedurat e prokurimit të zhvilluara apo kontratat e lidhura nga ana e autoritetit/eve kontraktor/e, të përcaktuara në VKM nr. 436, datë 26.06.2024, janë në shkelje të rregullave të prokurimit publik, me qëllim vlerësimin prej saj në marrjen e masave penalizuese, sipas nenit 132 të ligjit nr. 162/2020.
2. Në të gjitha rastet e njoftimit, mbi rastet e hetuara nga ana e Koordinatorëve kundër Korrupsionit apo strukturës përgjegjëse antikorrupsion për hetimet administrative, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi administrative, nëpunësit publik të autoritetit kontraktor apo dhe vetë operatorin/ët ekonomik fitues të kontratës, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit i përcjell APP, një ekstrakt të shkurtër të raportit përfundimtar të hetimit me gjetjet përkatëse.
3. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit kryen analizën dhe vlerësimin e riskut për korrupsion në fushën e prokurimit publik në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik.

Neni 6

Kontribute të përbashkëta

Palët angazhohen të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin sipas angazhimeve të ndërmarra në këtë marrëveshje, si dhe marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim forcimin e zbatueshmërisë së ligjit, zbatimin me rigorozitet të rregullave të prokurimit publik, rritjen e integritetit të administratës publike, garantimin e interesave pasurorë të shtetit dhe të drejtave të çdo subjekti pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Palët angazhohen që të bashkëpunojnë për hartimin e parashikimeve specifike që lidhen me integritetin e punonjësve publikë në procedurat e prokurimit publik, të cilat duhet të bëhen pjesë e planeve të integritetit të hartuara dhe miratuara nga institucionet/autoritetet kontraktore.

Palët angazhohen që të bashkëpunojnë në kuadër të profesionalizimit në fushën e prokurimit publik.

Neni 7

Administrimi i informacionit

1. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të dhëna nga pala tjetër dhe kanë detyrimin e mos shpërndarjes së këtij informacioni tek personat e paautorizuar.
2. Informacioni i shkëmbyer në kuadër të kësaj marrëveshje ndërmjet palëve nënshkruese do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Komunikimi ndërmjet palëve / Bashkërendimi i punës ndërmjet palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe/ose në rrugë elektronike, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.
2. Palët caktojnë një person kontakti, nëpërmjet të cilit do të kryhet shkëmbimi i informacionit në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Palët, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes, caktojnë një person kontakti dhe ia njoftojnë atë njëra-tjetrës.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi palët respektive lidhur me problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9

Ndryshimi dhe përfundimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet pjesërisht ose tërësisht me vullnetin e dakordësuar të palëve, i cili bëhet nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.
2. Gjithashtu, palët kanë të drejtë që me marrëveshje me shkrim midis tyre, të zgjidhin marrëveshjen në çdo kohë.
3. Në rast se njëra nga palët kërkon të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, ajo duhet të njoftojë palën tjetër, me shkrim brenda 1 (një) muaji.
4. Deri në përfundimin e kësaj marrëveshje, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin prej saj, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar.

Neni 12
Dispozita të fundit

1. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën fuqi juridike, 2 (dy) prej të cilave depozitohen pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe 2 (dy) të tjera në Agjencinë e Prokurimit Publik.
2. Kjo marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 30.12 2024.

**MINISTRI I SHTETIT PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN/
KOORDINATORI KOMBËTAR
KUNDËR KORRUPSIONIT**

për delegim dhe kompetencë

INSIDOR REXHEPI

(Drejtore i Përgjithshëm i Antikorrupsionit)




AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

REIDA KASHTA

(Drejtore i Përgjithshëm)


